



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:219706

Datë: 15.10.2024

Numri i dokumentit: 06296574

C.nr.661/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të paditësve F (M) G, B (M) G, G (H) G dhe K (V) G, që të gjithë nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati G.Sh nga Rahoveci, kundër të paditurit Sh (Q) Z nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e objektit të kontestit 3,100.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datën 14.10.2024, mori, ndërsa më datën 15.10.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET NË TËRËSI e bazuar kërkesëpadia e paditësve F (M) G, B (M) G, G (H) G dhe K (V) G, që të gjithë nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurit Sh (Q) Z nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit.

II. VËRTETOHET se paditësit F (M) G, B (M) G, G (H) G dhe K (V) G, që të gjithë nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, në bazë të parashkrimit fitues janë bashkëpronarë në pjesë ideale me nga $\frac{1}{4}$ pjesë të paluajtshmërisë së evidentuar si njësi kadastrale me nr.00465-0, ZK Bellacërkë, pronë private, vendi i quajtur “Zreke - Livade”, me kulturë ”Bujqësore – arë e klasës 2”, në sipërfaqe të përgjithshme tekstuale prej 4390 m², e cila kufizohet në anën lindore me parcelën nr.464-0, në gjatësi prej (pika 1-2) 50.67m + (pika 2-3) 57.39m + (pika 3-4) 57.35 m + (pika 4-5) 46.83m, në gjatësi të përgjithshme prej 212.24m, në anën jugore me parcelën nr.462-1, në gjatësi të përgjithshme prej (pika 5-6) në gjatësi prej 15.71m, në anën perëndimore me parcelën nr.2038 (Rrugë komasacioni) në gjatësi prej (pika 6-7) 29.76m + (pika 7-8) 28.34m + (pika 8-9) 21.56m + (pika 9-10) 32.44m, me parcelën kadastrale nr.466-2 në gjatësi prej (pika 10-11) 35.85m, dhe me parcelën nr.466-1 në gjatësi prej (pika 11-12) 20.98m + (pika 12-13) 56.52, në gjatësi të përgjithshme prej 225.45, dhe në anën veriore me parcelën nr.2291-0 (Rrugë publike) në gjatësi të përgjithshme prej (pika 13-1) 17.66m.

III. DETYROHET i paditurit Sh (Q) Z nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, që ta pranojnë këtë të drejtë dhe që të lejojnë regjistrimin e paluajtshmërisë nr.00465-0, ZK Bellacërkë, në emër të paditësve në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e

Rahovecit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit.

IV. Shpenzimet procedurale i bartë pala paditëse.

A r s y e t i m

Paditësit F (M) G, B (M) G, G (H) Gdhe K (V) G, që të gjithë nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi kundër të paditurit Sh (Q) Z nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes) në paluatjshmërinë - parcelën me nr.00465-0, ZK Bellacërkë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit si në padi ashtu edhe në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar faktin se paditësit me të paditurin, me kontratë gojore mbi shitblerjen e paluatjshmërisë, në vitin 1992, kanë blerë parcelën kadastrale me nr. 465-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4390 m², ZK Bellacërkë. Po ashtu, e theksoi faktin se paditësit i kanë kryer të gjitha obligimet ndaj të paditurit, duke përfshirë edhe pagesën e shitblerjes, e në anën tjetër, i padituri ua ka dorëzuar në posedim të lirë dhe shfrytëzim të lirë parcelën paditësve dhe që nga ajo kohë paditësit nuk janë penguar nga askush. Më tej ka shtuar se gjykata, pas zbatimit të procedurës së provave, e sidomos me daljen e gjykatës, së bashku me ekspertin e gjeodezisë, në vend, si dhe nga deklarimi i të paditurit, ku i njëjti nuk e ka kundërshtuar pretendimin e paditësve, ka vërtetuar faktin se paditësit, ndaj të paditurit, i kanë kryer të gjitha obligimet, sipas marrëveshjes gojore, po ashtu është vërtetuar fakti se paditësit janë në posedim dhe shfrytëzim të lirë të parcelës në fjalë. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

I padituri në përgjigjen në padi, seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë, si të tillë e pohon. I njëjti ka theksuar se janë të vërteta të gjitha të thënat si në padi, ashtu edhe në seancën e sotme nga përfaqësuesi i paditësve. Pas pranimit të ekspertizës i njëjti ka theksuar se me kohë nga ana e gjykatës e kanë pranuar ekspertizën, nga eksperti i gjeodezisë, si dhe ndaje njëjtës nuk kanë vërejtje, dhe as pyetje për ekspertin.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ka caktuar shqyrtimin kryesor në të cilin kanë prezantuar palët ndërgjyqëse, ka caktuar ekspertizën e gjeodezisë dhe se bashku me palët ndërgjyqëse ka dalë në vend. Eksperti i gjeodezisë është obliguar që të bëjë identifikimin e parcelës, sipërfaqen, kufizimet e parcelës dhe kush është në shfrytëzim të saj.

Gjithashtu, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

1. Ekstraktin nga certifikata, me numër të lëndës 08-942/03-0045339/22, i datës 07.10.2022 dhe

2. Ekspertizën e gjeodezisë, e ekspertit Armend Metbala nga Rahoveci, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 19.07.2024.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar duke qenë se i padituri e ka pohuar kërkesëpadinë që nga fillimi i procedurës e deri në përfundim të saj, ku i padituri Sh (Q) Z pohimin e kërkesëpadisë e ka bërë personalisht.

Gjykata me administrimin e ekstraktit të paluajtshmërisë numër 08-942/03-0045339/22, i datës 07.10.2022 dhe ekspertizës së gjeodezisë të datës 19.07.2024 (të cilave ua dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se parcela nr. 00465-0-0 Zona Kadastrale Bellacërkë, me sipërfaqe prej 4390 m² evidentohet në emër të Sh (Q) Z, me pjese ideale 1/1.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadisë nga i padituri, ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse sipas propozimit të paditësve me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vend shikimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thëniet në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga i padituri, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi që i padituri është evidentuara si pronar i paluajtshmërisë, që vërtetohet përmes ekstraktit të pronës me nr. 08-942/03-0045339/22, i datës 07.10.2022.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurit, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)”*, vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 455 LPK-së, gjykata ka vendosur sikurse në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA E THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.661/2022 më datë 15.10.2024

Numri i lëndës: 2022:219706
Datë: 15.10.2024
Numri i dokumentit: 06296574

Gjyqtari
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimi të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.